



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1309/2 Prot

Gramsh më 26.05.2020

VENDIM

Nr.32 Datë 30.04.2020

PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË PAGESAVE TË DETYRIMEVE PËR TAKSA E TARIFA VENDORE

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 30. 04.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për shtyrjen e afatit të pagesave të detyrimeve për taksa e tarifa vendore", në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" i ndryshuar, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Aktit normativ Nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", i ndryshuar, Aktit normativ Nr.4, datë 16.03.2020 "Për masat administrative për mosrespektimin e kufizimeve nga individët", Urdhërit Nr.132, datë 08.03.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura", Urdhërit Nr.156, datë 10.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", Urdhërit Nr. 193, datë 20.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për kufizimin apo mbylljen e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB Nr. 96, datë 30.12.2019 "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore ,administrimin e tyre si dhe penalitetet apo kundravajtjet administrative ",si dhe sipas relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë,me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore nga data 30 Prill ,për në datën 31 Korrik 2020, për subjektet e biznesit të vogël.
2. Të miratojë shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore nga data 30 Qershor ,për në datën 31 Korrik 2020, për subjektet juridike.
3. Subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 përjashtohen nga kamatvonesat dhe ccdo lloj penaliteti tjetër brenda afatit 31 Korrik 2020.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Sektori i Tatim-Taksave.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Konceptoi: E.Mema

 Sekretari i Këshillit

Kryetari i Këshillit

Miratoi: G.Lena

 Endri MEMA

 Greta LENA

Konfirmoi: G.Lena

Adresa: Sheshi "Kamber Dermynshi" Rruga "10 Korriku" ,E- Mail: bashkia.gramsh2017@gmail.com